




MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Komunës së Gjakovës

Dhe

Organizatës Jo-Qeveritare “Marakli t’Biciklave”

Komuna e Gjakovës dhe OJQ “Marakli t’Biciklave” (më tutje referuar si Palët), shprehin vullnetin e tyre për të bashkëpunuar mbi bazën e mirëbesimit dhe mirëkuptimit reciprok, pasqyruar kjo përmes këtij Memorandum Bashkëpunimi.

Palët angazhohen për të shkëmbyer informacionet dhe përvojat respektive në fushën e çiklizmit.

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

Palët do të jenë pjesë e një bashkëpunimi me qëllim të shkëmbimit të eksperiencës dhe praktikave më të mira nëpërmjet:

- Shkëmbimit të modeleve sa më efikase për të rritur interesimin e qytetarëve të Gjakovës për çiklizëm
- Krijimit të infrastrukturës dhe sigurisë së çiklistëve në komunikacion
- Informimin e ngasësve të automjeteve për respektimin e çiklistëve në komunikacion
- Rregullat e ngasjes së biçikletës dhe shenjat e komunikimit gjatë ngasjes së saj
- Përfshirjen e qytetarëve në aktivitete të përbashkëta dhe të veçanta promovuese të çiklizmit
- Informimin e qytetarëve për të mirat shëndetësore që na sjell çiklizmi dhe dobitë e mëdha në ruajtjen e ambientit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Me qëllim zbatimin me korrektësi të këtij Memorandumi Palët angazhohen:

- Të realizojnë projekte të përbashkëta me qëllim të rritjes së informacionit tek qytetarët për çiklizmin dhe rritjen e numrit të çiklistëve

2. Organizimin e aktiviteteve të çiklistëve me qëllim vizitën e pasurive natyrore dhe historiko-kulturore të Komunës së Gjakovës
3. Palët angazhohen të ofrojnë këshilla, asistencë, ofrimin e materialeve mbështetëse për realizimin e këtyre projekteve
4. Palët angazhohen të llojnë në favor të njëra-tjetrës për çështje të interesit publik
5. Komuna e Gjakovës angazhohet të përkrahë me shpenzime operative për mbarëvajtjen e aktivitetit i cili do të mbahet në fund të muajit Maj nga OJQ “Marakli t’Biciklave”
6. Komuna e Gjakovës angazhohet të njoftojë OJQ “Marakli t’biciklave” për propozimet /nismat dhe projektet që kanë të bëjnë me çiklizmin në Komunën e Gjakovës

Neni 3

Kërkesat dhe Ekzekutimet

1. Kërkesat e palëve në këtë Memorandum do të paraqiten me shkrim ndaj personave kontaktues përgjegjës. Në raste urgjente, kërkesat mund të paraqiten shkurtimisht dhe më pas do të ndiqen me kërkesën e plotë
2. Pala, së cilës i është bërë kërkesa, do ta trajtojë atë në kohën më të përshtatshme
3. Çdo kërkesë do të vlerësohet nga pala përkatëse nëse informacioni i kërkuar mund të ofrohet brenda kornizave të këtij Memorandumi. Në çdo rast, kur kërkesa nuk pranohet si e plotë, pala ndaj të cilës është paraqitur kërkesa do të konsiderojë nëse mund të ketë ndonjë informacion relevant apo të pjesshëm, për të cilin mund të ofrohen shpjegimet e nevojshme

Neni 4

Përfaqësimi i Palëve

Të gjitha komunikimet midis Palëve duhet të bëhen midis personave përgjegjës të kontaktit, të caktuar nga palët.

Neni 5

Aplikueshmëria e Memorandumit

Ky Memorandum do të shërbejë si bazë për bashkëpunim ndërmjet palëve. Ky Memorandum nuk ka për qëllim krijimin e detyrimeve ligjore, e as të tejkalojë ndonjë kërkesë ligjore apo rregullative në fuqi. Ky Memorandum nuk prodhon asnjë të drejtë të ekzekutueshme për palët e treta.

Hyrja në fuqi e përcaktimeve sipas këtij Memorandumi do të jetë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe nuk do të jetë në kundërshtim me interesin publik. Memorandumi bazohet në respektimin e plotë të standardeve më të larta profesionale dhe kodit të etikës.

Neni 6

Ndryshimi i Memorandumit

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin unanim të të dy palëve dhe kohëzgjatja e tij është në vullnetin e lirë të palëve

Neni 7

Hyrja në fuqi e Memorandumit

Memorandumi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy Palët dhe është i vlefshëm për sa kohë që të dy palët të kenë interes të përbashkët

Palët do të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi

Neni 8

Përfundimi i Memorandumit

Memorandumi do të mbetet në fuqi derisa njëra nga palët të njoftojë palën tjetër me shkrim se do rishikojë, ndryshojë apo të tërhiqet nga ky Memorandum. Secila palë mund të përfundojë këtë Memorandum duke njoftuar me shkrim palën tjetër në afat jo më të shkurtër se 60 (gjashtëdhjetë) ditë. Memorandumi do quhet i përfunduar 60 ditë pas datës së marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

Memorandumi mbahet në dy kopje origjinale, nga një kopje për secilën prej palëve.

Gjakovë, më 10.06.2021

KOMUNA E GJAKOVËS



Nënshkrimi

Kryetari: Ardian Gjini



MARAKLI T'BICIKLAVE



Nënshkrimi

Kryetari: Berat Rakovica